



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.272, datë 10.07.2023

PËR
“CAKTIMIN NË DETYRËN E PROKURORIT”

Bazuar në pikën 1 të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 39 dhe 41 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 189, pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë zonjën Denisa Perdja, në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
2. Të njoftohen për këtë vendim zonja Denisa Perdja, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. Ky vendim mund të ankënohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
5. U shpall në Tiranë, sot më 10.07.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ledina Riza

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda